



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202400035/4

Tiranë ___/___/2024

Lënda: Rekomandim për përfshirjen e shtetases Olsjana Guri, kryefamiljare e nënë e divorcuar me dy fëmijë në skemën e Ndhmës Ekonomike

BASHKISË BERAT

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE SOCIALE

BERAT

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, mbështetur në pikën 1, të nenit 60 të Kushtetutës, si dhe ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, mori për shqyrtim ankesën e shtetases Olsjona Guri, duke kërkuar informacion zyrtar nga Bashkia Berat¹.

Shtetësja Guri është nënë e divorcuar dhe kujdeset për mirërritjen e dy fëmijëve të saj duke jetuar në një shtëpi me qera. Ish-bashkëshorti i saj është i papunë dhe nuk paguan detyrimin e pensionit ushqimor të fëmijëve të tij të vendosur nga gjykata. Aktualisht, ajo është punësuar si sanitare (part time) me një pagë mujore në masën 10.000 (dhjetëmijë lekë) lekë në muaj plus sigurimet shoqërore në një ndërmarrje sociale². Këto të ardhura janë të pamjaftueshme për kujdesin dhe mirërritjen e vajzave të saj 7 dhe 3 vjeç. Znj. Guri, edhe pse ka aplikuar disa herë pranë Bashkisë Berat për t'u përfshirë në programet e mbrojtjes sociale, nuk është përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike.

Në përgjigje të shkresës së AP-së me nr. K5/O1-2 prot. datë 22.01.2024, "Kthim përgjigje" Bashkia Berat ka sqaruar si më poshtë vijon:

¹ Shkresa zyrtare me nr.K5/01-2prot., datë 22.01.2024 e institucionit të Avokatit të Popullit

² ligj nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë"

“Znj. Olsjona Guri është mbështetur me të gjitha shërbimet mbështetëse nga sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore. Sapo, është paraqitur në drejtorinë e Shërbimeve Sociale muajin shtator 2023 është asistuar nga PMF-ja për aplikimin në e-albania për ndryshimin dhe saktësimin e vendbanimit të saj. Nga PMF-ja në muajin gusht 2023 është informuar për t’u përfshirë në projektin “Aftësojmë dhe integrojmë në tregun e punës”, ku pas një cikli trajnimesh për zhvillimin profesional si baby sitter dhe përkujdesje për moshën e tretë ka nisur punësimi në ndërmarrjen sociale pranë kompanisë së pastrimit “Crystal Time” me një pagesë në shumën 10 000 (dhjetë mijë) lekë me sigurime shoqërore të paguara, dhe orare të reduktuara, të cilat përshtaten me orarin për mirërritjen e vajzave. Organizata TLAS i ka siguruar blerjen e kuponit për aplikimin e kartës së identitetit, nëpërmjet PMF-së si dhe është mbështetur me paketa ushqimore në muajin nëntor 2023. Gjithashtu, është asistuar dhe mbështetur për plotësimin e dokumentacionit përkatës për të bërë të mundur përfshirjen e saj në programet e strehimit për bonus qeraje. Gjatë dy muajve dhjetor 2023 dhe janar 2024 znj. Guri ka aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike pranë Administratorit të Rajonit 3 në Bashkinë Berat por nuk është përfituese, për mosplotësimin e pikëve. Në vazhdimësi, Bashkia Berat informon se Administratori shoqëror i Rajonit 3 së bashku me grupet e terrenit, do të kryejë vizitë në familjen Guri, për vlerësimin e kushteve social-ekonomike me qëllim përfshirjen e saj në fondet 6% të bashkisë në programin e ndihmës ekonomike³.”

AP-ja vlerëson punën e bërë nga strukturat përgjegjëse në Bashkinë Berat referuar masave të marra për rastin në fjalë. Por, masat e ndërmarra nuk kanë qenë efektive në përmirësimin e kushteve social-ekonomike të familjes së znj. Guri për të plotësuar nevojat e vajzave të saj për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen në një familje me standarde normale. Gjithashtu, aplikimi i programeve aktive si “*ndërmarrjet sociale*” janë një risi e Bashkisë Berat si një mundësi reale për nxitjen e punësimit të kategorive në nevojë.

Bazuar në pikën 2, kreu II, të vendimit nr.597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike” “...*administratori shoqëror, pasi verifikon situatën social-ekonomike të familjeve në nevojë nëpërmjet vizitave në familje dhe në terren, brenda muajit të aplikimit për*

³ Shkresa zyrtare me nr.508/1 prot., datë 05.02.2024 të Bashkisë Berat

familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për të gjitha familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike hedh në regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënave sipas formularit të shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.....”. Për rrjedhojë familjes së znj. Guri, kryefamiljare (grua e divorcuar me dy fëmijë), e cila ka aplikuar dy herë në sistemin e ndihmës ekonomike pranë Administratës së Rajonit nr.3 në Bashkinë Berat, duhej t’i ishte verifikuar situata social-ekonomike e familjes, nëpërmjet vizitës në familje dhe në terren nga Administratori shoqëror i Rajonit nr 3, brenda muajit dhjetor 2023, si aplikuese për herë të parë.

Avokati i Popullit nënvizon se Bashkia Berat duhet të trajtojë me prioritet rastin e znj.Guri si grua kryefamiljare, e divorcuar që kujdeset për mirëritjen e dy fëmijëve të saj në shtëpi me qera me të ardhura 10.000 (dhjetëmijë lekë) lekë në muaj, ku ish-bashkëshorti i saj është i papunë dhe nuk paguan detyrimin e pensionit ushqimor të fëmijëve të tij të vendosur nga gjykata. Pavarësisht se nuk është shpallur përfituese nga skema e ndihmës ekonomike në nivel kombëtar situata e saj duhet vlerësuar me qëllim për t’u përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% i Ndihmës Ekonomike të Bashkisë Berat. Kësaj familjeje duhet t’i kushtohet një vëmendje e veçantë si një familje me fëmijë e të ardhura të uleta që ka nevojë për mbështetje sociale.

Skema e Ndihmës Ekonomike është shtylla kryesore e programit të mbrojtjes sociale, e cila synon zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë, duke siguruar pagesa dhe mbështetjen e familjeve dhe individëve më në nevojë, për të dalë nga varfëria dhe për të gjetur mundësitë e riintegrit social dhe ekonomik. Ndonëse skema e ndihmës ekonomike është instrumenti kryesor për “zbutjen e varfërisë” në vend, aktualisht mund të ketë një ndikim të kufizuar në përmirësimin e gjëndjes së varfërisë, referuar raporteve të standardit të minimumit jetik në Shqipëri, realizuar nga Avokati i Popullit në bashkëpunim me UNDP⁴, ku minimumi që i duhet një personi për të garantuar nevojat bazë në Shqipëri është 17 875 lekë në muaj duke marrë në konsideratë dhe indeksimin e kësaj mase në raport me inflacionin.

Bazuar në pikën 3, të nenit 6, të ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme, ku aftësitë e

⁴https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/ëbsite/reports/Raport%20p%C3%ABr%20Standardi%20e%20Minimumit%20Jetik%20n%C3%AB%20Shqip%C3%ABri%202020_b5DMuoq.pdf

prindërve që kujdesen për mirërritjen e fëmijës t’iu përgjigjen nevojave të fëmijës. Ky parim duhet të aplikohet nga autoritetet shtetërore përfshirë dhe bashkitë në të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe gjyqësore që kanë ndikim në jetën e fëmijëve.

AP-ja ka hartuar raportin e veçantë “Politikat e pensionit ushqimor, detyrimin për ushqim, për fëmijët” dorëzuar në Kuvendin e RSH-së në të cilën ka adresuar problemet e mospagesës së pensionit ushqimor nga prindi debitor. Në këtë raport është konstatuar se **legjislacioni ynë i brendshëm nuk mundëson kompensimin e detyrimit ushqimor** nga Shteti dhe vendosjen e marrëdhënies debi-kredi, midis prindit që detyrohet dhe Shtetit. Përmirësimi i legjislacionit në këtë drejtim për rastet kur burimet e të ardhurave të prindërve nuk i përmbushin nevojat e fëmijës, do të mundësonte që **shteti të merrte masa për të kompensuar pjesën e të ardhurave që duhet për të përballuar nevojat e fëmijës.**⁵

Thënë kjo, në kontekstin e rastit në fjalë ku, ish-bashkëshorti i znj.Guri dhe babai i vajzave është i papunë dhe nuk paguan detyrimin e pensionit ushqimor të fëmijëve të tij të vendosur nga gjykata.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.

Ndaj, referuar parashtrimin të mësipërm, Avokati i Popullit për çështjen në fjalë,

REKOMANDON:

- Marrjen e masave për përfshirjen e familjes Guri, në skemën e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% i Bashkisë Berat për periudhën kohore në vazhdimësi për të garantuar zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social të fëmijëve të saj, si dhe një jetë familjare e sociale të përshtatshme për ta.
- Marrjen e masave për përfshirjen e saj në programet e strehimit për bonus qeraje si grua kryefamiljare që ka në ngarkim mirërritjen e dy vajzave të mitura 3 dhe 7 vjeç⁶.

⁵[https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/ëbsite/reports/Raporti%20mbi%20politikat%20e%20pensionit%20ushqimor%20-%202012.1.2023\[125951\].pdf](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/ëbsite/reports/Raporti%20mbi%20politikat%20e%20pensionit%20ushqimor%20-%202012.1.2023[125951].pdf)

⁶ bazuar në gërmen “i/b” të nenit 16 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit.

Për sa më sipër, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe në vijim të na informoni për qëndrimin tuaj ndaj tij.

Duke Ju falënderuar dhe në vijim të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, shpresoj dhe besoj në gjykimin Tuaj për vlerësimin e këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R

Olta ALIAJ